

## THIRRJE PËR PUNËTORI NJË-DITORE NË KUMANOVË

***E ardhmja që duam! Jetë paralele! Botimi i tretë*****Vendi: Kumanovë****Data: 03.06.2021****Koha: 11:00 – 16:00.****Grupa e qëllimit: nxënës të shkollave të mesme****Gjuha e punës: maqedonisht dhe shqip****Afati për aplikim: 28.05.2021****MË SHUMË INFORMACIONE RRETH PROJEKTIT**

Projekti "E ardhmja që duam! Jetë paralele! Edicioni i Tretë" synon përmes aktiviteteve të përbashkëta, të mundësojë pjesëmarrësit të identifikojnë rreziqet dhe pasojat e mundshme të ndarjes në shkolla, sepse ata nuk kanë mundësinë të takojnë "tjetrin". Përmes këtij projekti pjesëmarrësit do të mësojnë se si të njohin dhe si ti kalojnë stereotipet dhe paragjykimet.

Projekti do të zhvillohet në 3 faza:

1. Punëtorit një ditore lokale
2. Kampi i paqes në Strugë
3. Akcione lokale

Punëtoritë njëditore lokale do të mbahen në Kumanovë, Strugë dhe Strumicë dhe do të përqendrohen në afrimin, si dhe në kuptimin e temave të identitetit dhe multikulturalizmit.

Kampi i paqes do të mbahet në fund të qershorit në Strugë dhe do të zgjasë 5 ditë. Në kamp do të marrin pjesë 8 pjesëmarrës nga Kumanova, Struga dhe Strumica të cilët do të kenë mundësinë të thellohen në temat e mësimi ndërkulturor dhe tejkalimin e stereotipave dhe paragjykimeve. Gjatë kampit të paqes, pjesëmarrësit do të mësojnë gjithashtu për pjesëmarrjen e të rinjve dhe do të kenë mundësinë të planifikojnë veprime lokale për të ndërmarrë në komunitetet e tyre pasi të kthehen në shtëpi.

Pasi pjesëmarrësit të pajisen me njohuri dhe aftësi, pasi të kenë fituar përvojë nga Kampi i Paqes, ata do të mbështeten nga mentorë në kryerjen e veprimeve lokale në mënyrë që të shumëfishojnë njohuritë e tyre dhe të angazhojnë më shumë të rinj në komunitetet e tyre lokale. Veprimet lokale do të synojnë të rrisin zërin e ndarjes në shkolla. Aksioni do të jetë në formën e punëtorive, artit në rrugë, shfaqjeve artistike, aksioneve guerile, ekspozitës së fotografive, etj.

## INFORMACIONE RRETH PUNËTORISË NJË-DITORE

Punëtorja njëditore në Kumanovë do të mbahet më 3 qershor duke filluar nga ora 11:00 dhe do të zgjasë deri në orën 16:00. Vendndodhja e saktë do t'u dërgohet pjesëmarrësve të zgjedhur.

Dreka do të sigurohet për të gjithë pjesëmarrësit.

Do të respektohen të gjitha masat dhe rekomandimet për mbrojtjen dhe parandalimin e Covid-19.

## PROFILI I PJESMARRËSVR:

- Nxënës të shkollave të mesme të Kumanovës
- Të interesuar në temë
- Të motivuar për pjesmarrje